

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 06 . 08 .2021, u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

**Z. Vasil Mero**, shtetas shqiptar, lindur më 25.03.1952 në Suhë, Gjirokastrë, mbajtës i pasaportës me Nr. personal F20325020R, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar , zotërues i 25% të kuotave/pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë “La Strada” SH.P.K, me nr. NUIS: K91511005Q, nga këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”,

dhe,

**“Inter Media Group” SH.P.K.**, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në: Rruga “Rezervat e Shtetit”, Lundër, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L61429018R, përfaqësuar nga administratori Z. Theodhoro Çami, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që këtu e më poshtë do të quhet “**Blerësi**”.

### Neni 1 Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të 25% (njëzetë e pesë përqind) të kuotave të kapitalit, me një vlerë të përgjithshme prej ALL 19.796.286,75 ALL (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë Lekë), që Shitësi zotëron në shoqërinë “La Strada” SH.P.K.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, shoqëria “Inter Media Group” SH.P.K do të zotërojë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “La Strada” SH.P.K.

### Neni 2 Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **19.796.286,75 ALL (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë Lekë)**

### Neni 3 Mënyra e pagesës

3.1 Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të likuidohet nga blerësi në favor të shitësit brenda 10 (dhjetë) viteve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

3.2 Çmimi do t'i paguhet blerësit me këste mujore me vlerë të barabartë.

#### **Neni 4 Detyrimet e shitësit**

4.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë “La Strada” SH.P.K, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

4.2 Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

4.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

#### **Neni 5 Detyrimet e Blerësit**

5.1 Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

5.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5.3 Blerësi bie dakord që pronësia mbi kuotat do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe jo në momentin e shlyerjes së çmimit të shitjes.

#### **Neni 6 Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi**


6.1 Kjo kontratë hartohet në 3 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

6.2 Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

6.3 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

#### **SHITËSI**

**Z. Vasil Mero**

(Vasil Mero)  


#### **BLERËSI**

**“Inter Media Group” SH.P.K.**

(përfaqësuar nga)

Z. Theodhoro Çami

  
**INTER MEDIA GROUP Sh.p.k**  
**NUIS: L61429018R**  
**Tiranë**